



PERMBLEDHJE

ALBINSPEKT  
RREGULLAT E KUIVALENTE  
MBI  
RREGULLOREN E KESHILLIT (EC) 834/2007

**Tiranë, në Shtator 2009**



## Hyrje

I nderuar Klient,

Albinspekt dëshiron t'ju informojë mbi ndryshime të rëndësishme ligjore për vitin 2009 e në vazhdim.

Midis shërbimeve të ofruara nga Albinspekt, inspektimet dhe certifikimet sipas Rregullores Organike të Bashkimit Evropian, janë më të shpeshta. Kjo rregullore është baza ligjore për importet në BE.

Sipas ndryshimeve të reflektuara në Rregulloren EEC 834/2007, respektivisht Neni 33 "Importet e produkteve që sigurojnë garanci ekuivalente", pika 3, Albinspekt ka përcaktuar rregulla të detajuara për zbatimin e kërkesave të Rregullores së BE-së 834/2007 për certifikim nga Albinspekt.

Këto rregulla (5.7.1 Rregullat Ekuivalente të Albinspekt) përfshijnë pjesë të Rregullores EEC 834/2007 dhe rregullave të saj të zbatimit, të cilat nuk janë të zbatueshme ose janë të ndryshme në zonat ku Albinspekt ushtron aktivitetin e tij. Këto rregulla janë të detyrueshme kudo ku Rregullorja e BE-së nuk është e zbatueshme.

Për të gjithë klientët tanë, ne do të përshkruajmë në këtë dokument ndryshimet kryesore midis Rregullat Ekuivalente të Albinspekt mbi Rregulloren EEC 834/2007 dhe vetë Rregullores së EEC 834/2007.

Ju lutem mbani parasysh se teksti zyrtar i Rregullave Ekuivalente të Albinspekt do të jetë gjithnjë dokumenti vendimtar dhe se kjo përmbledhje nuk mund të japë informacion që ka vlerë ligjore.

*Ne jemi të gatshëm t'ju përgjigjemi pyetjeve më të detajuara mbi Rregullat Ekuivalente dhe Rregullat e Importit, në çdo kohë.*

**Rregullat Ekuivalente të Albinspekt mbi EEC 834/2007 (fusha e veprimit të EEC 834/2007)**

### Fusha e veprimit

(Neni 1, Qëllimi dhe fusha e veprimit)

Këto rregulla do të zbatohen për: produkte bujqësore të gjalla ose të pa përpunuara; produkteve bujqësore të përpunuara për përdorim

si ushqim, material shtues vegjetativ, dhe fara për kultivim; maja e përdorur si ushqim ose ushqim për kafshë.

Fusha e veprimit e këtyre Rregullave Ekuivalente nuk përfshin akuakulturën, algat e detit, ushqimin për kafshë dhe për kafshë shtëpiake.

### Lista e Inputeve Pozitive e Albinspekt

(Neni 16, Produktet dhe substancat e përdorura në bujqësi dhe kriteret për autorizimin e tyre)

Albinspekti mund të autorizojë substanca shtesë duke ndjekur në kriteret e parashtruara në Rregulloren e BE-së 834/2007 dhe në përputhje me Codex Alimentarius – GL 32. Në rast se Albinspekt autorizon substanca të ndryshme nga ato të publikuara në anekset e Rreg 889/2008, do të informojë trupën e Akreditimit dhe BE-në në përputhje me rrethanat dhe të japë justifikimin.

Albinspekt ka krijuar Procedurën mbi Listën e Imputeve Pozitive (LIP), dhe brenda 2009 do t'a bëjë atë publike dhe cdo informacion tjetër lidhur me përdorimin e disa substancave dhe produkteve.

### Rregullat e vecanta të prodhimit

(Neni 22, Rregullat e vecanta të prodhimit)

Albinspekt, mund të marrë parasysh përjashtimet e lëshuara nga Komisioni në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të Nenit 22 dhe mund të marrë masa për dhënien e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit të përcaktuara në Kapitujt 1 deri 4 të Rregullores së BE 834/2007.

### Etiketimi

(Neni 24, Treguesit e detyrueshëm)

Për etiketimin e produkteve kur përdoren termat e përmendura në Nenin 23(1), kodi i Albinspektit nuk do të shfaqet në etiketë (Albinspekt end enuk ka një kod numerik). Por është i detyrueshëm përmendja e emrit të Albinspekt në etiketimin e produktit të certifikuar nga Albinspekt.

Përdorimi logos së Komunitetit është vullnetar për produktet e importuara.

### Sistemi i kontrollit

(Neni 27, Sistemi i kontrollit)

Albinspekt është përgjegjës për kontrollet e kryera tek operatorët që zbatojnë Rregullat Ekuivalente të tij. Të gjitha procedurat e kontrollit dhe veprime të tjera të rëndësishme do të kryhen sikurse parashikohet në Manualin e Cilësisë së Albinspekt. Ai është në proces të akreditimit ndërkombëtar sipas EN 45011

Meqënëse Shqipëria nuk është një shtet i BE-së, nuk është e mundur të kemi një Autoritet Kompetent.



Albinspekt do të konsiderohet si autoriteti kompetent në përputhje me këtë rregullore.

#### Aplikimi për certifikim sipas këtyre Rregullave Ekuivalente

(Neni 28, Zbatimi i sistemit të kontrollit)

Operatorët që aplikojnë për certifikim ekuivalent sipas Rregullores së BE 834/2007, duhet të përmbushin formularin e aplikimit 9.2.001 dhe t'a dërgojnë atë pranë Albinspektit.

#### Shkeljet

(Neni 30, Masat në rast shkeljesh ose parregullsish)

Kur hasset një shkelje e rëndë ose shkelje me efekt të gjatë kohor, Albinspekti do të ndalojë operatorin në fjalë të shesë produktet duke iu referuar si prodhim organik në etiketë dhe reklamim, sipas katalogut të sanksioneve.

Informacion mbi rastet e parregullsive ose shkeljeve që ndikojnë statusin organik të një produkti do të komunikohen menjëherë mes trupave të kontrollit, autoriteteve të kontrollit dhe në rast eksporti, Shtetet Anëtare të përfshira dhe kur është me vend dhe Komisionin.

#### Importet

(Neni 32 dhe 33, Importi i produkteve që përputhen ose që japin një garanci ekuivalente)

Në rast se operatorët që aplikojnë për certifikim tek Albinspekt për import produktesh, këto produkte do të konsiderohen organike sipas 5.7.1 Rregullat Ekuivalente të Albinspekt me Rregulloren e BE 834/2007, nëse ata janë certifikuar si në përputhje ose ekuivalente me Rregulloren e BE 834/2007, prej një trupe certifikimi të miratuar sipas Rregullores së BE 834/2007, Neni 27 ose Neni 32 dhe 33.

#### Përshtatshmëria

Nenet vijuese të Rregullores së BE 834/2007 nuk kanë lidhje me këto Rregulla Ekuivalente, sepse vendet ku vepron Albinspekt nuk janë Shtete Anëtare të BE:

Nenet 34-37

Nenet 39-41.

## **Rregullat Ekuivalente të Albinspekt mbi EEC 834/2007 (qëllimi Rregullorja 889/2008)**

#### Fusha e veprimit

(Neni 1, Qëllimi dhe Fusha e veprimit)

Kjo Rregullore nuk zbatohet për: produktet me origjinë nga akuakultura; algat e detit; speciet e gjësë së gjallë të ndryshme nga ato të përmendura në Nenin 7 të Rregullores 889/2008.

#### Linjat me rritje të ngadaltë në shpendëve

(Neni 12, Kushtet specifike të strehimit dhe praktikat e mbarështimit të shpezëve)

Një listë për linjat me rritje të ngadaltë do të hartohet nga Albinspekt sapo një shtet anëtar të këtë publikuar një listë të këtillë; duke u mbështetur në këtë listë. Kjo listë do të jetë e vlefshme dhe publike.

#### Dendësia e kafshëve

(Neni 15, Dendësia e strehimit)

Dendësia e përgjithshme e strehimit do të jetë e tillë që mos të kalojë kufirin prej 170 kg azot në vit dhe hektar të sipërfaqes bujqësore. Për të përcaktuar dendësinë e duhur të gjësë së gjallë të përmendur më lartë, Albinspekt do të zbatojë shifrat e përcaktuara në Aneksin IV të Rregullores së BE 834/2007 dhe nuk do pranojë shmangie.

#### Menaxhimi i gjësë së gjallë

(Neni 18, Menaxhimi i gjësë së gjallë)

Operatorët mund të kërkojnë autorizim nga Albinspekt për veprime të tilla si ngjitja e shiritave elastik në bishtat e deleve, shkurtimi i bishtit, prerja e dhëmbëve, prerja e sqepit dhe heqja e brirëve; për arsye sigurie ose nëse kryhen me qëllimin për të përmirësuar shëndetin, mirëqenien ose higjienën e gjësë së gjallë, bazuar sipas rastit. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim, të jetë e specifikuar për tipin dhe numrin e kafshëve si dhe të sigurojë justifikim për rastet specifike dhe të përshkruaj si do të shmangen këto veprime në të ardhmen. Albinspekt do të japë autorizime bazuar sipas rastit dhe për një afat të caktuar kohe.

#### Përbërësit ushqimorë jo-organikë

(Neni 29, Autorizimi i përbërësve jo-organik të ushqimit me prejardhje bujqësore nga Shteti Anëtar)

Aty ku një përbërës me prejardhje bujqësore nuk është i përfshirë në Aneksin IX të kësaj Rregulloreje, ai përbërës mund të përdoret vetëm nëse:

- operatori ka lajmëruar Albinspektin duke sjellë prova se përbërësi në fjalë nuk është prodhuar në sasi të mjaftueshme në vendin



e veprimtarisë, në përputhje me rregullat e prodhimit organik ose nuk mund të importohet nga vendet e treta;

- Albinspekt ka autorizuar përkohësisht përdorimin për një periudhë prej 12 muajve;
- asnjë vendim nuk është marrë që autorizimi i dhënë sa i përket përbërësit në fjalë të tërhiqet.

Albinspekt mund të shtyjë autorizimin e parashtruar në pikën (b) më së shumti tre herë për 12 muaj për secilën.

#### Ushqimi i kafshëve jo-organik

(Neni 43 Përdorimi i ushqimit jo-organik për kafshët me origjinëe bujqësore)

Afatet për përdorimin e përqindjeve të ushqimit jo organik për kafshët janë zgjatur për t'ju përshtatur kushteve lokale në Shqipëri dhe Kosovë, ku sektori organike është ende në zhvillim dhe gjendshmëria e ushqimit organik për kafshët duhet konsideruar. Sasia maksimale e ushqimit jo-organik për kafshët e autorizuar për një periudhë prej 12 muajsh për speciet e tjera veç atyre barngrënëse, do të jetë: 10 % për periudhën nga 1 Janar 2009 deri në 31 Dhjetor 2010; 5 % për periudhën nga 1 Janar 2011 deri në 31 Dhjetor 2013.

Operatori duhet të mbajë regjistrimet përkatëse për nevojën për ta përdorur këtë pika.

#### Farat, fidanët dhe materiali shtues vegjetativ

(Neni 45 - 48, Përdorimi i farëve ose materialit shtues vegjetativ që nuk janë përfituar me metodën e prodhimit organik, etj)

*Farat dhe materiali shtues vegjetativ:* Aty ku nuk është e mundur zbatimi i përdorimit të farave ose materialit shtues vegjetativ i përfutur nga metodat organike të prodhimit, Albinspekt zbaton politikën e mëposhtme.

Nëse nuk ka fara dhe materiali shtues vegjetativ organik, operatori mund të përdorë material konvencional të patrajtuar me lejen paraprake nga Albinspekt. Këto leje do të jepen përpara mbjelljes.

Farat ose materiali vegjetativ gjykohet se është i gjendshëm nëse një varietet fare ose materiali vegjetativ ofrohet nga një kompani ose fermë e cilat është e publikuar në bazën e të dhënave siguruar nga Albinspekt. Një listë e tillë do të përpunohet deri në fund të vitit 2009.

Duke u shmangur nga sa më sipër, leje të veçanta mund të jepen nga Albinspekt nëse furnizuesit e përmendur më sipër nuk mund të sigurojnë sasi të mjaftueshme ose cilësi të përshtatshme, për të përdorur fara ose material shtues vegjetativ të trajtuar me substanca të tjera vec atyre të lejuara nën këtë Rregullore.

Speciet për të cilat do të caktohet se fara ose material shtues vegjetativ të prodhuar organikisht janë të gjindshme në sasi të mjaftueshme do të përfshihen në Listën e farave të Albinspekt, Aneksi X.

*Fidanët:* duhet të jenë nga metodat e prodhimit organik. Fermeri mund të rrisë fidanët e tij nëse fidanë organike nuk gjenden në treg.

#### Etiketimi i produkteve në kalim

(Neni 62 – Produktet me origjinë bimore në kalim)

Produktet me origjinë bimore në kalim mund të mbajnë treguesin “produkt në kalim drejt bujqësisë organike”. Treguesi duhet të paraqitet në ngjyrë, formë dhe stil shkronjash të cilat nuk janë më të spikatura sesa përshkrimi i shitjes mbi produkt.

**Në rast se keni nevojë për më tepër informacion mbi 5.7.1 Rregullat Ekuivalente të Albinspekt, ju lutem kontaktoni në:**

[contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)

ose

Tel/fax 22 38 554

ose vizitoni

[www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com)

#### **Albinspekt**

Adresa: Rruga Ded Gjon Luli, Pall. 5, Shk. 1, Ap. 8, Tiranë, Shqipëri

Tel / Fax: + 355 4 223 8554

Cel: + 355 68 20 62 262

E-mail: [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)

[www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com)

#### **Shtator 2009**